

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, me gjyqtarin Arben Hoti në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit H.Q., për shkak të veprës penale Mbjajta në pronësi ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së, i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.1077-5/09, dt. 30.11.2015, pas shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt.03.09.2018 në të cilën ish-in të pranishëm prokurori i shtetit – JavorkaPerlincevic, i pandehurit H.Q., si dhe përkthyesja e kësaj gjykate IlmijeSopjani, në të njëjtën ditë gjykata mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: H.Q., i biri i M. dhe A., e gjinisë B., i lindur me dt. ..., në fshatin T., KK D. ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, b., i martuar, baba i ... fëmijëve, përfitues i ndihmës sociale të invalidit të luftës, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:ekziston dyshimi i bazuar mirë se me dt. 26.10.2009 rreth orës 15:30 minuta në lagjen “Q.” në fshatin T., KK D., ka përdorur armën me frikësim dhe kërcënim në atë mënyrë pasi që ka nxjerr nga brezi pistoletën e kalibrit 7.65 mm, ia ka drejtuar të pandehurit H.Q., dhe të dëmtuarit H.Q., duke i mbajtur në shënjestër me c ‘rast te këta persona ka shkaktuar ndjenja të rrezikut për jetë dhe të pasigurisëintegritetit fizik, ndërkaq posa është kthyer në oborrin e shtëpisë së vet ka shkrepu një plumb për pjet.

- me këtë ka kryer veprën penale: Mbjajta në pronësi, dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet;3,6,11,34,35,36,39,41,42,43,44,64,65,66,67 të KPK-së si dhe nenit 365 të KPPRK –së, të pandehurin e gjykon:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurin H.Q., i caktohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej**8(tetë) muaj**,i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në periudhën prej **1 (një) viti**.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari R.Q., me vendbanim në fshatin T., KK D., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko – civil.

Konform nenit 60 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPRK-së konfiskohet: pistoleta e prodhimit Gjerman, me kalibër 7.65 mm, një karikator dhe tre fishek, sipas vërtetimit mbi konfiskimin e sendeve të lëshuar nga stacioni policor në D. me dt.26.10.2009 dr. 2009 AG 1059.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzën PP.nr 1077-5/09, dt. 30.11.2015, me të cilën ka akuzuar të pandehurin H.Q.n për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328/1 të KPK-së.

Me datë 03.09.2018, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP.nr 1077-5/09, dt. 30.11.2015, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par. 4 të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri H.Q., në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, duke shtuar se është penduar për veprën e kryer, të dëmtuarin e ka kushëri, se në ditën kritike ka ndodhur një kacafytje në mes të disa fëmijëve të familjeve të tyre, dhe me qëllim që mos të vije deri te më e keqja duke menduar ashtu në atë kohë, ka përdorur armën në mënyrën e përshkruar, dhe që nga ajo kohë familjet e tyre nuk kanë pasur probleme në mes veti.

Prokurori i shtetit JavorkaPerlincevic, sa i përket pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar, se: pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit , duke i propozuar gjykatës që një pranim fajësie ta aprovojë sepse është në përputhshmëri me ligjin, në bazë të provave të propozuara në aktakuzë. Andaj i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit të dënimit të ketë parasysh provat e propozuara në aktakuzë, ndërsa si rrethanë lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar.

Meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPRK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, siç janë: Vërtetimi mbi konfiskimin e armës e municionit nga H.Q., lëshuar nga stacioni policor në D., i dt 26.10.2009 nr. 2009 AG 1059, foto dokumentacionin e vendit të ngjarjes, si dhe gjitha shkresat tjera të lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 64 të KPK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, andaj edhe ka aplikuar dispozitat për zbutje konform nenin 66 të KPK-së, pastaj si rrethanë lehtësuese gjykata moripendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, moshën e tij, si dhe gjendjen e dobët financiare.Gjykata nuk gjeti rrethana veçanërisht rënduese. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim burgimi me kusht si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cila është kryer vepra

penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 54 par.2 nënpar.7 të KPK-së dhe nenit 115 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë në vështrim të nenit 463/2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. nr. 681/15, datë 03.09.2018

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.